

V E N D I M

Nr.74 Date 24.06. 2008


**PER DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE TË
ERE-S NR. 41, DATE 31.08.2005 "PER MIRATIMIN E KONTRATES SE
FURNIZIMIT ME ENERGJI ELEKTRIKE PER KLIENTIN E KATEGORISE
JOFAMILJARE**

Në mbështetje të neneve 9, dhe 44 pika 1, dhe 45 pika 2, të Ligjit Nr.9072, datë 22.05.2003, "Për Sektorin e Energjisë Elektrike", te ndryshuar, pikes 2, paragrafi 10 dhe 12, te Modelit te Tregut te Energjise Elektrike te miratuar me Vendimin e Keshillit te Ministrave Nr. 338 date 19.03.2008, dhe neneve 121 dhe 128 te Ligjit nr.8485 date 12.05.2008 "Kodi i Procedurave Administrative te Republikes se Shqiperise", Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 24.06.2008, mbasi shqyrtoi propozimin per ndryshimin e Vendimit te Bordit te Komisionereve Nr.41 date 31.08.2005 "Per miratimin e kontrates se furnizimit me energji elektrike per klientin e kategorise jofamiljare" dhe konstatoi se:

- Ligji per sektorin e energjise elektrike dhe Modeli i tregut te energjise elektrike percaktojne pergjegjesine e furnizuesit publik me pakice ne furnizimin me energji elektrike te klienteve tarifor
- OSSH sh.a eshte mbajttese e licenses se furnizimit publik me pakice,
- Deri me tani kontratat e furnizimit me energji elektrike te klienteve tarifore jane realizuar nga KESH sh.a, cka nuk i korrespondon ndryshimeve te ndodhura ne kuadrin ligjor ne sektorin e energjise elektrike



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I
SEKTORIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE
Bordi i Komisionereve



Per gjithë sa me sipër Bordi i Komisionereve,

Vendosi:

1. Në Vendimin nr. 41, date 31.08.2005 ” Per miratimin e kontrates se furnizimit me energji elektrike per klientin e kategorise jofamiljare” behen keto shtesa dhe ndryshime:

1) Ne titullin e vendimit pas fjales *jofamiljare* shtohen fjalet : *nga furnizuesi publik me pakice (OSSH sh.a).*

2. Ne piken 1 te vendimit pas fjales *jofamiljare* shtohen fjalet: - *nga furnizuesi publik me pakice (OSSH sh.a).*

3- Pas pikes 1 te vendimit shtohet pika 2 me permbajtjen:

Ne kontraten bashkelidhur vendimit kudo ku thuhet furnizuesi ose furnizimi me energji elektrike do te kuptohet furnizimi nga Furnizuesi publik me pakice (OSSH sh.a).

2. Duke filluar nga data 1 korrik 2008 OSSH sh.a eshte pergjegjese per zbatimin e kontratave te furnizimit me energji elektrike te klienteve jofamiljare, te rinj dhe egzistues.

3. Ngarkohet Furnizuesi Publik me Pakice (OSSH sh.a) per zbatimin e ketij vendimi

Ky vendim hyn ne fuqi me date 1 korrik 2008.

Ky vendim botohet ne Fletoren Zyrtare

Kryetari i ERE-s

Bujar Nepravishta